

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-550 W Elastic

VESHJE MBROJTËSE PËR MBYLLJEN E PLASARITJEVE TEK BETONI.



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-550 W Elastic është veshje plasto-elastike me 1 përbërës me bazë dispersioni akrilik që thahet me rrezatimin UV, e cila ka veti të shkëlqyera për mbyllje plasaritjesh edhe në temperatura nën 0 °C. Sikagard®-550 W Elastic plotëson kërkesat e EN 1504-2 si veshje mbrojtëse.

PËRDORIMET

Sikagard®-550 W Elastic përdoret për mbrojtje dhe përmirësim të strukturave prej betoni (beton normal dhe me peshë të lehtë), veçanërisht sipërfaqet e jashtme të ekspozuara prej betoni me rrezik plasaritjeje.

Sikagard®-550 W Elastic përdoret për punime riparimi të betonit si një veshje mbrojtëse elastike mbi llaçin nivelues Sika® (referohuni në skedën teknike të produktit / sistemit përkatës), çimenton me fibra dhe mbiveshje të veshjeve ekzistuese me ndërkapje të qëndrueshme

- I përshtatshëm për mbrojtje kundër hyrjes së ujit (Parimi 1, metoda 1.3, EN 1504-9),

- I përshtatshëm për kontroll të lagështisë (Parimi 2, metoda 2.3, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rritje të rezistencës (Parimi 8, metoda 8.3, EN 1504-9)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngushtim plasaritjesh edhe në temperatura të ulëta (-20°C)
- Rezistencë e lartë ndaj difuzionit të CO₂ duke ulur shkallën e karbonimit
- I përshkueshëm nga avulli i ujit
- Rezistencë shumë e mirë ndaj vjetërimit dhe ndikimeve të motit
- Miqësor ndaj mjedisit (pa tretës)
- Tendencë e reduktuar për mbledhje papastërtish dhe kontaminimesh

MIRATIME / STANDARDE

Testim i performancës sipas EN 1504-2, Raporti LPM A-33'882-2 data 09 korrik

Produkti është përfshirë në një përmbledhje produktesh dhe sistemesh të testuara sipas OS 5a (OS DII) në Institutin Gjerman të Sistemeve të Rugëve

Përcaktimi i vetive të mbylljes së plasaritjeve dinamike sipas EN 1062-7, raport P8690a data 27/08/2014, Kiwa Polymer Institut GmbH

Veshje mbrojtëse sipas EN 1504-2, DoP 02 03 03 03 002 0 000003 1125; certifikuar nga organi i kontrollit të prodhimit në fabrikë: 0921; certifikatë 0921-BPR-2046 dhe mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Dispersion akrilatesh
Ambalazhi	kovë plastike ovale 15 l
Paraqitja / Ngjyra	Lëng tiksotropik i disponueshëm pothuajse në çdo ngjyrë.
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur.

Kushtet e magazinimit Të ruhet në kushte të thata dhe të freskëta. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrirja.

Dendësia ~ 1.39 kg/l (në +20°C)

Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë ~ 66.1%

Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim ~ 53.4%

TË DHËNA TEKNIKE

Zgjatimi deri në thyerje	Zgjatimi deri në thyerje ▪ në temperaturë dhome (pa ekspozim në kushtet e motit): 120% ▪ në -20°C: 70%
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	2,9 (2,8) N/mm ² (EN 1542)
Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve	Kategoria A1 (-20°C) - 2 veshje (EN 1062-7) Kategoria B2 (-15°C) - 3 veshje
Rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje dhe kripërave akullshkrirëse	2,9 (2,1) N/mm ² (EN 13687 part 1 & part 2)
Reagimi pas vjetërimit artificial	Kalon pas 2000 orësh (EN 1062-11)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	Trashësia e cipës së thatë d = 230 µm (EN ISO 7783-1) Trashësia ekuivalente e shtresës së ajrit SD, H ₂ O = 0.35 m (EN ISO 7783-2) Koeficienti i difuzionit të H ₂ O µH ₂ O = 1,5 x 10 ³ Kërkesat për transpirim ≤ 5 m
Absorbueshmëria kapilare	w = 0,02 kg/(m ² h ^{0.5}) (EN 1062-3)
Përshkueshmëria e dioksidit të karbonit	Trashësia e cipës së thatë d = 160 µm (EN 1062-6) Trashësia ekuivalente e shtresës së ajrit SD, CO ₂ = 51 m Koeficienti i difuzionit të CO ₂ µCO ₂ = 3,1 x 10 ⁵ Kërkesat për mbrojtje SD, CO ₂ ≥ 50 m

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Sistemi	Produkti ¹⁾	Nr. i aplikimeve
	Prajmer ²⁾	Sikagard®-552 W Aquaprimer	1
	Veshja përfundimtare ³⁾	Sikagard®-550 W Elastic	2 – 3

¹⁾ Ju lutemi referohuni në skedën teknike të produktit përkatës për informacione shtesë.

²⁾ Për nënshtresë shumë të vështirë (shumë të dendur ose të dobët me rezistencë ndaj tërheqjes < 1 N/mm²) dhe në temperaturë të ulët, përdorni prajmerin me bazë tretësi Sikagard®-551 S Elastic Primer.

³⁾ Në rast ngjyre të verdhë të ndezur ose të kuqe dhe/ose nënshtresë të errët, mund të kërkohej më tepër se dy veshje.
Kërkohej gjithashtu një veshje e tretë për të arritur trashësinë e kërkuar për qëndrueshmëri të plotë (mbyllje plasaritjesh, ndërkapja pas cikleve termike, etj.)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Produkti	Për veshje												
	Sikagard®-551 S Elastic Primer	~ 0.10 - 0.15 kg/m ²												
	Sikagard®-552 W Aquaprimer	~ 0.10 - 0.15 kg/m ²												
	Sikagard®-550 W Elastic	~ 0.25 - 0.35 kg/m ²												
Trashësia e shtresës	Trashësia minimale e kërkuar e cipës së thatë për arritjen e karakteristikave të kërkuara (trashësia ekuivalente e ajrit CO ₂ 50 m) ≈ 160 µm. Trashësia <i>minimale</i> e kërkuar e cipës së thatë për arritjen e karakteristikave të qëndrueshmërisë së plotë (difuzion CO ₂ , ndërkapja pas ciklit termik dhe ngushtimit të plasaritjeve) ≈ 340 µm.													
Temperatura e mjedisit	+8°C min. / +35°C max.													
Lagështia relative e ajrit	< 80%													
Pika e vesës	Temperatura duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.													
Temperatura e nënshtresës	+8°C min. / +35°C max.													
Koha e pritjes / mbiveshja	Koha e pritjes ndërmjet veshjeve në temperaturë nënshtrese +20°C: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Veshja e mëparshme</th> <th>Koha e pritjes</th> <th>Veshja vijuese</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Sikagard®-552 W Aquaprimer</td> <td>min.5 orë</td> <td>Sikagard®-550 W Elastic</td> </tr> <tr> <td>Sikagard®-551 S Elastic Primer</td> <td>min.18 orë</td> <td>Sikagard®-550 W Elastic</td> </tr> <tr> <td>Sikagard®-550 W Elastic</td> <td>min. 8 orë</td> <td>Sikagard®-550 W Elastic</td> </tr> </tbody> </table> <p>Shënim: Kur aplikimi bëhet mbi veshjet ekzistuese, koha e pritjes për të dy prajmerat do të rritet me 100%. Veshjet rifreskuese të Sikagard®-550 W Elastic mund të aplikohen pa prajmer nëse veshja ekzistuese është pastruar plotësisht.</p>		Veshja e mëparshme	Koha e pritjes	Veshja vijuese	Sikagard®-552 W Aquaprimer	min.5 orë	Sikagard®-550 W Elastic	Sikagard®-551 S Elastic Primer	min.18 orë	Sikagard®-550 W Elastic	Sikagard®-550 W Elastic	min. 8 orë	Sikagard®-550 W Elastic
Veshja e mëparshme	Koha e pritjes	Veshja vijuese												
Sikagard®-552 W Aquaprimer	min.5 orë	Sikagard®-550 W Elastic												
Sikagard®-551 S Elastic Primer	min.18 orë	Sikagard®-550 W Elastic												
Sikagard®-550 W Elastic	min. 8 orë	Sikagard®-550 W Elastic												
Metoda e maturimit	Sikagard®-550 W Elastic nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë, por duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 4 orë në +20°C.													
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Tharja e plotë: ~ 7 ditë në +20°C													

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton i ekspozuar pa veshje ekzistuese:

- Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e qëndrueshme dhe pa grimca të lira dhe të shkrifëta.
- Metodat e përshtatshme të përgatitjes janë pastrimi me avull, curril uji me presion të lartë ose pastrim me fryrje.
- Betoni i ri duhet të ketë moshë prej të paktën 28 ditësh.
- Nëse kërkohet, një izolues poredh nivelues (p.sh. Sika® MonoTop®-723 N, Sikagard®-720 EpoCem®, Sikagard®-545 W Elastofill, etj.) duhet aplikuar - referohuni tek skeda teknike përkatëse. Për produkte me bazë çimentoje, lini kohë tharjeje prej të paktën 4 ditësh përpara veshjes (me përjashtim kur përdoret EpoCem, atëherë veshja mund të aplikohet brenda 24 orëve).

Beton i ekspozuar me veshje ekzistuese:

- Veshjet ekzistuese duhet të testohen për të konfirmuar ndërkapjen dhe përshtatshmërinë e tyre me nënshtresën - mesatarja e testit të ndërkapjes > 0.8 N/mm² me asnjë vlerë të vetme nën 0.5 N/mm².
- Për veshje me bazë uji, përdorni Sikagard-552 W Aquaprimer si prajmer.
- Për veshje me bazë tretësi, përdorni Sikagard-551 S

Elastic Primer si prajmer.

- Në rast dyshimi, kryeni testimin e ndërkapjes për të përcaktuar se cili prajmer është më i përshtatshëm - prisni të paktën 2 javë përpara kryerjes së testit të ndërkapjes - kërkohet një vlerë mesatare prej 0.8 N/mm² me asnjë vlerë të vetme nën 0.5 N/mm².

APLIKIMI

Aplikoni Sikagard®-551 S Elastic Primer ose Sikagard®-552 W AquaPrimer në mënyrë të njëtrajtshme mbi nënshtresë. Për përdorim mbi nënshtresa shumë të dendura mund të shtohet deri në 10% Sika Thinner C tek Sikagard®-551 S Elastic Primer.

Sikagard®-550 W Elastic mund të aplikohet me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

Për më shumë detaje, referohuni tek Method Statement për aplikimin e veshjes mbrojtëse.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë të pastër menjëherë pas përdorimit.

Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Për Sikagard®-551 S Elastic Primer përdorni Sika® Thinner C.

KUFIZIME

Mos aplikoni kur:

- Priten rreshje shiu
- Lagështia relative > 80%
- Temperatura është nën +8°C dhe/ose nën pikën e vesës
- Betoni ka moshë më të re se 28 ditë

Sistemi është rezistent ndaj ndikimeve atmosferike agresive.

Ngjyrat e errëta (veçanërisht e zeza, e kuqja e errët dhe bluja, etj.) mund të zhduken më herët sesa ngjyrat e tjera të lehta. Mund të kërkohet veshje rifreskuese në interval më të hershëm se zakonisht.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-550 W Elastic

Mars 2019, Botimi 01.01

020303030020000001

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / c lloji wb) është 40 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e Sikagard®-550 W Elastic është < 40 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikagard-550WElastic-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf